



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2968/2 prot

Datë 30.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “*Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit per objektet e OSSH sh.a dhe objektet ne administrim te FSHU sh.a*”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Clean Fast” SHPK dhe “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK, me NIPT L51712008C dhe adresë: Rruga “Siri Kodra”, Nr.8340, Nr.pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr.8, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA, me adresë: Rruga “Reshit Petrela”, përballë Dispanserisë, Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK me NIPT L61807037R dhe adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Godina ETC, Kati 13, Tiranë

Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK me
NIPT K91628013D dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr. 9,
Rruga “Asim Vokshi”, Alb building 2t, kati i 2, Tiranë

Në datën 30.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi A/2023/3654 dhe nr. 2968/2023 protokolli, datë 30.11.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “*Sherbimi i pastrimit dhe dezinfektimit per objektet e OSSH sh.a dhe objektet ne administrim te FSHU sh.a*”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa tvsh), zhvilluar më datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Clean Fast” SHPK dhe “Alko Impex Construction” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK.

Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

“1. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Formularin e Sigurimit te Ofertes (shtojca 3) ne emer te dy anetareve te BOE sipas nenit 88, pika 2 VKM nr.285 date 19.05.2021 I ndryshuar.

2. Operatori Ekonomik nuk ka plotesuar sakte Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit (shtojca 9) dhe konkretisht:

- Ne aneksin B) Deklaraten “ Per Dorezimin e Ofertave te Pavarura”, pika 6.

- Pjesa III, Kriteret e Perzgjedhjes/Kualifikimit, Aneksi B) “Per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme (nese kerkohen).

3. Operatori Ekonomik nuk ka percaktuar sipas formatit te DST Shtojcen Nr.2.

4. Operatori Ekonomik nuk ka plotesuar sakte piken 2.3.6 te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit ne DST, konkretisht:

- Mungojne dokumentat shoqeruese, fotot per mjetin “Platforme Levizese” dhe specifikimet teknike te krahut te vincit.”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Clean Fast” SHPK dhe “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon si më poshtë, citojmë:

“Në lidhje me kualifikimin e kundraligjshëm të OE “Clean Fast” SHPK me Nipt: L61807037R përveç kriterit të sipërpërmendur shtojmë edhe faktin se ky OE nuk plotëson kriterin e kualifikimit në lidhje me pikën 2.2.1 të kriterëve të kualifikimit për xhiron vjetore, pikën 2.2.3 për pagesën e detyrimeve të taksave vendore, pikën 2.3.1 për kontratat e ngjashme dhe pikën 2.3.2 për numrin e punonjësve dhe dokumentacionin shoqërues. Sa më sipër kërkojmë refuzimin e ofertës të këtij OE.”

Në lidhje me kualifikimin e kundraligjshëm të OE “Alko Impex Construction” SHPK me Nipt: K91628013D përveç kriterit të sipërpërmendur shtojmë edhe faktin se ky OE nuk plotëson kriterin e kualifikimit në lidhje me pikën 2.2.1 të kriterëve të kualifikimit për xhiron vjetore, pikën 2.2.3 për pagesën e detyrimeve të taksave vendore, pikën 2.3.1 për kontratat e ngjashme dhe pikën 2.3.2 për numrin e punonjësve dhe dokumentacionin shoqërues. Sa më sipër kërkojmë refuzimin e ofertës të këtij OE.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 30.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri